



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1009/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër Bali Muharremaj, kandidat për kryetar komune nga subjekti politik (AAK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, gjatë ditës së zgjedhjeve, në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), në Prishtinë, kështu që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 250 (dyqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 02.12.2013 ka pranuar një ankesë, nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 01 dhjetor 2013, BIRN në cilësinë e vëzhguesit të certifikuar nga KQZ-ja, ka monitoruar respektimin e heshtjes zgjedhore nga partitë politike në mediat sociale. Vëzhguesi i BIRN-it thekson se aty ka vërejtur që Bali Muharremaj kandidat për kryetar të komunës së Suharekës nga subjekti politik (AAK), ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë përmes postimit të një fotografie në rrjetin social të Facebook-ut, e cila fotografi i udhëzon qytetarët që të votojnë për të. Përmesë kësaj fotografie është bërë fushatë e hapur dhe ky veprim bie ndesh me nenin 36 të ligjit për zgjedhjet e pergjithëshme.

Në cilësinë e provës ankesa ka të bashkangjitur fotot nga facebook.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi AAK më datën 03.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013 deri në ora 10:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga AAK, në të cilën deklaroi se z. Bali Muharremaj nuk posedon fare faqe të tij personale zyrtare në rrjetin social Facebook dhe për të vërtetuar mund të kërkonte në rrjetin social dhe posa të shkruani emrin Bali Muharremaj do të ju hapen së paku 7 (shtatë) profile në emrin e tij, të cilat i kanë hapur persona të panjohur dhe këtë mund ta bëjë çdo njeri, qoftë aktivist i AAK-së ose nga jashtë saj. Përgjigjes në ankesë AAK ia ka bashkëngjitur Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregulloret e KQZ-së të datës 21 gusht 2013 dhe kërkesën drejtuar shërbimit të Shtabëve Zgjedhore për respektim të Kodit zgjedhor të datës 04 tetor 2013.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihen qartë fotografitë e postuara nga Bali Muharremaj, kandidat për kryetar të komunës së Suharekës në rrjetin social Facebook, të postuara në ditën e votimit me datë 01.12.2013, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 7.1 pika b), e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe me nenin 36.1 pika b) të LZP-së, e cila përcakton bërjen e fushatën në çfarëdo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e kandidatit për kryetar të komunës së Suharekës Bali Muharremaj nga AAK, është shkelur neni 7 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, pasi që postimi i kandidatit Bali Muharremaj është bërë në rrjetin social Facebook, PZAP, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 1009/2013 më datën 04.12.2013.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*